

## DOKUMENT REKOMANDIMESH PËR POLITIKAT

Dokumenti i Rekomandimeve, vjen si rezultat i zhvillimit të Forumit Vjetor të Profesionistëve të Rinj: “Transformimi Digjital, Domosdoshmëri për Formësimin e së Ardhmes” që synonte rritjen e kontributit të profesionistëve të rinj shqiptarë në politikë-bërje, si vazhdimësi e disa zhvillimeve të rëndësishme kombëtare dhe botërore.

Ky dokument është realizuar nga puna në grupe e profesionistëve të rinj, studentëve dhe përfaqësuesve të organizatave, raportuar dhe konkluduar nga moderatorët, reporterët e grupeve dhe punuar më tej nga grupi i ekspertëve.

*Zhvillimin i tij, u bazua në katër prioritete të rëndësishme për cilësinë e jetës të profesionistëve të rinj si:*


1. **Aksesi në të dhëna;**
2. **Siguria Kibernetike;**
3. **Prioritetet e Rinisë në Inovacion**
4. **Edukimi Digjital.**

Si rrjedhojë, ky kontribut vjen përkundrejt zhvillimit të “Strategjisë së Rinisë 2022 – 2029”, në mënyrë të tillë që interesat dhe rekomandimet e profesionistëve të rinj mbi Agjendën Digjitale dhe rininë të përkthehen në politika të ardhshme rinore.

Më poshtë, rekomandimet janë ndarë në dy drejtime: në infrastrukturë dhe aftësi - se si të rinjtë mund të kenë më shumë prioritet dhe siguri lidhur me aksesimin, edukimin dhe sigurinë digjitale - dhe në aktorë - se si këto rekomandime krijojnë nevojën e përfshirjes së aktorëve relevantë në implementimin dhe përkthimin e tyre në politika rinore.

### **Infrastrukturë & Aftësi**


- Përmirësimi i infrastrukturës online digjitale (software, mbulim me internet) për ndjekjen e kurseve dhe leksioneve online nga çdo cep i Shqipërisë nëpërmjet krijimit të tech-hub në çdo bashki për të mundësuar përfshirjen e të rinjve nga qytetet më të vogla dhe nga zonat rurale.



- Rritja e investimeve të digjitalizimit në shkolla nëpërmjet specializimit të mësuesve për zhvillimin e lëndës TIK dhe përmirësimin të teksteve shkollore dhe infrastrukturës fizike në shkolla.
- Rritja e aftësive digjitale për të rinjtë me qëllim përshtatjen me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin e aftësive për të lexuar, përpunuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike informacionin dhe thyerjen e privatësisë në hapësirën digjitale.
- Zhvillimi i Literaturës Online për t'i dhënë mundësinë të gjithë të rinjve kudo që ndodhen në territorin Shqiptar dhe jashtë tij, të aksesojnë tekstet shkollore online.
- Ndërmarrja e fushatave të ndërgjegjësimit mbi aksesin në mënyrë të sigurtë të të rinjve në ekosistemin kibernetik si dhe me njohjen e rrugëve institucionale që duhet të ndjekin në rast se konstatojnë sulme/kryeve kibernetike. Rekomandohet si fillim promovimi i ligjit nr 2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike" që ka si qëllim arritjen e një niveli të lartë të sigurisë kibernetike, duke përcaktuar masat e sigurisë, të drejtat, detyrimet, si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet subjekteve që operojnë në fushën e sigurisë kibernetike.
- Rritja e shkëmbimeve dhe bashkëpunimit të profesionistëve të rinj në rajon nëpërmjet skemave rajonale të punësimit, zhvillimit dhe edukimit.
- Zhvillimi i programeve konkrete dhe me linja buxhetore të përcaktuara, krahas planeve të veprimit nga njësitë bashkiake lidhur me të rinjtë dhe qytetarinë aktive sipas nevojave.
- Krijimi i një platforme online ku të rinjtë të kenë mundësi të aksesojnë mundësi për trajnime, konferenca, praktika pune si dhe informacione të lidhura me zhvillimin e tyre në nivel kombëtar.
- Zhvillimi i regjistrave elektronikë për të dhënat e studentëve dhe nxënësve në shkolla, notave, mungesave etj.
- Publikimi i rregulloreve online në faqet e ueb për të gjithë institucionet që operojnë me të dhënat personale të qytetarëve të rinj dhe jo vetëm.

## Aktorët

- "Strategjia e Rinisë" të jetë në një linjë me "Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025", e hartuar nga Autoriteti Kombëtar për



Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, specifikisht me qëllimin e politikës 3: “Krijimi i mekanizmave të nevojshëm për sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike, duke përgatitur njëkohësisht brezin e ri të aftë për të përfituar nga përparësitë e teknologjisë së informacionit dhe për të përballuar sfidat e zhvillimit”.

- Zhvillimi i tryezave të bashkëpunimit me qëllim rritjen e koordinimit të aktorëve të nivelit qendror me njëri tjetrin për të evituar mbivendosje agjendash dhe programesh;
- Rritja e koordinimit midis aktorëve të nivelit qendror me ato të nivelit lokal për të përkthyer në masa dhe investime konkrete politikat rinore dhe politikat për të rinjtë.
- Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit me OJF-të që operojnë në nivel kombëtar dhe agjencitë kombëtare për koordinimin e politikave rinore, orientimin e investimeve dhe përthithjen e fondeve.
- Promovimi i bashkëpunimit me sektorin privat në krijimin e kushteve të punës dhe kontratave të punës më fleksibël për të rinjtë duke aplikuar sistemin e punës dhe pagesës me orë.

